

# *Gjuha juridiko-diplomatike: Analizë stilistikore e tekstit të “Konventës për Municionet Thërrmuese”<sup>1</sup>*

Aida Alla\*

## **Abstrakti**

Gjuha angleze është pa dyshim gjuha më e rëndësishme e komunikimit midis kombeve të ndryshme anë e mbanë botës. Është *lingua franca* në shumë takime ndërkombëtare, qofshin ato politike, ekonomike, sociale, artistike, letrare, etj. Në këtë kuadër, ndërveprimi diplomatik dhe politik midis kombeve është duke u rritur gjithnjë e më shumë, duke rritur, për rrjedhojë, edhe kërkesën për profesionalizëm në përkthim. Ligjet ndërkombëtare duhet të përkthehen saktësisht me qëllim që t'i përshtatet mentalitetit kombëtar, kulturor dhe politik të vendit të gjuhës së përkthimit.

Ky punim adreson çështjen e përkthimit të dokumenteve juridike të cilave kohët e fundit po i kushtohet vëmendje e veçantë, me fokus në një prej zhanreve me të ndjeshme, atë të konventave ndërkombëtare. Kemi zgjedhur të analizojmë tekstin në gjuhën angleze (në origjinal) dhe versionin e përkthyer në shqip të Konventës së Kombeve të Bashkuara për Municionet Thërrmuese,<sup>2</sup> të cilën Shqipëria e ka ratifikuar dhe është Shtet Palë. Do të fokusohemi te karakteristikat dhe veçoritë e gjuhës diplomatike-politike, në veçanti për stilin dhe tonin e konventës për municionet thërrmuese, për rëndësinë e disa njohurive paraprake si për hartuesit e këtyre dokumenteve ashtu edhe për përkthyesit.

---

<sup>1</sup> “Cluster Munitions” është përkthyer “municionet thërrmuese” në Republikën e Shqipërisë dhe “municione kasetore” në Republikën e Kosovës. Unifikimi i termave juridike në gjuhën shqipe është një domosdoshmëri, por ky aspekt shkon përtej qëllimit të këtij studimi.

\* Aida Alla, PhD Candidate, Kolegji AAB, email: aida.alla@aab-edu.net

<sup>2</sup> Teksti i plotë mund të gjendet online në:

<http://www.clusterconvention.org/files/2011/01/Convention-ENG.pdf>

Gjithashtu, do të bëjmë një analizë stilistike me shembujt e vjelë nga konventa në fjalë në anglisht dhe në shqip për të kuptuar më mirë këto karakteristika. Edhe pse do të ballafaqojmë të dyja gjuhët – originalin dhe materialin e përkthyer – nuk mund ta konsiderojmë këtë analizë si kontrastive. Në fokusin e kësaj kumtese nuk është ballafaqimi i mjeteve gjuhësore i të dyja gjuhëve për të parë dallimet dhe ngjashmëritë. Përkundrazi, do të fokusohemi te stili dhe toni i konventës dhe se si këto dy komponentë janë pasqyruar me anë të mjeteve gjuhësore në secilën gjuhë.

**Fjalë kyç:** *gjuha ligjore, stili, toni, standardizimi i terminologjisë, probleme përkthimore*

### ***Karakteristikat dhe natyra e gjuhës administrative***

Gjuha e dokumenteve juridike ka një natyrë shumëdisiplinore e cila kërkon njohuri në disa lëmi, si për shembull: njohuri mbi ligjet, njohuri gjuhësore se si këto dokumente shkruhen dhe çfarë duhet të shkruhet në to si dhe komunikimi ndërkulturor. Për sa i përket natyrës së gjuhës ligjore, sipas Deborah Cao, gjuha juridike ka natyre normative, performative, teknike dhe pragmatike.<sup>3</sup> Natyra performative ka të bëjë me krijimin e normave, prodhimin e normave dhe shprehësinë e normave. Gjuha normative e ligjeve vjen prej faktit se ligji ka funksionin kryesor në një shoqëri që të drejtojë sjelljen e njerëzve dhe të rregullojë marrëdhëniet midis njerëzve, pra të paraqes norma për ata.<sup>4</sup> Natyra normative e gjuhës shprehet me disa mjete gjuhësore të cilat tregojnë modalitet urdhërues dhe udhëzues.

Për sa i përket natyrës performative të gjuhës ligjore, ashtu si aspekti normativ, ajo është e lidhur me funksionin e ligjeve. Ligjet krijohen për t'u zbatuar, pra që njerëzit të veprojnë dhe të marrin masa.<sup>5</sup> Për shembull: Ju jeni gjobitur me 200 Euro. Pra, kjo fjali e shkurtër nënkupton në mënyrë explicite që personi i gjobitur duhet të bëjë një veprim: të paguajë gjobën. Aspekti performativ arrihet me tonin formal të përpilimit të këtyre dokumenteve.

---

<sup>3</sup> Deborah Cao. *Translating law*. Clevedon, 2007, fq.13.

<sup>4</sup> Ibid.

<sup>5</sup> Ibid. p. 14.

Natyra teknike e gjuhës juridike, sipas Deborah Cao, është evidente në të gjitha këto tekste pasi përmbajtja e tyre përbëhet me terma teknike ku tregojnë çfarë duhet bërë dhe si duhet bërë. Është një gjuhë për qëllime të caktuara, në rastin konkret për arsye administrative, diplomatike, politike dhe juridike.<sup>6</sup> Kjo shprehet me mjete gjuhësore tërësisht informative dhe jo emotive. Mendimi personal nuk duhet të shprehet në asnjë mënyrë.

### ***Stili dhe toni i konventës***

Stili i dokumenteve juridike bie nën kategorinë e stilit standard për kundrejt atij individual të cilin e hasim në tekste të letërsisë. Organizimi standard është një mënyrë tradicionale, e përgjithësuar, është një modelim për ta dhënë përmbajtjen atëherë kur synohet po ai qëllim dhe në po atë situatë komunikimi. Strukturim i paracaktuar do të thotë se teksti i ri (ajo që po shkruajmë ose po themi) ka marrëdhënie me thëniet, me tekstet e mëparshme ose të njëkohshme me të, madje do të ketë edhe huazime të elementëve konkretë ose pjesë të tëra ligjërimore.<sup>7</sup>

Sipas prof. Xhevat Lloshit, funksioni stilistik i ligjërimit është kumtues dhe parashtrues, domethënë jo vetëm thuhet me fjalë diçka, por edhe tregohet çfarë duhet bërë, çfarë urdhërohet të bëhet, çfarë është e pranishme dhe duhet marrë si e tillë e të mos ndryshohet. Ai thekson se si hartuesit ashtu edhe përkthyesit duhet t'u përmbahen disa normave dhe kritereve. Kërkesa e parë është që gjithçka të paraqitet e të bëhet në emër të shtetit apo institucionit, nga pikëpamja e përgjithshme e interesave të tij dhe jo të ligjëruesit të veçantë. Shfaqet në mënyrë të theksuar përpjekja për të mënjanuar qëndrimet e trajtimet nga ana vetjake, individuale, rrjedhimisht shmangët shprehja e drejtpërdrejtë e ndjenjave dhe reagimeve të ligjëruesit. Kërkesa e dytë është që paraqitja gjuhësore jo vetëm të bëhet me përpikëri por edhe të përfshijë imtësitë dhe rrethanat në mënyrë të shprehur.

---

<sup>6</sup> Ibid. p. 16.

<sup>7</sup> Xhevat Lloshi, *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, Second Edition, Tirana, 2005, fq. 51.

Kërkesa e tretë është që tekstet të shërbejnë si mbështetje për komunikimin në shumë veprimtari të kësaj fushe duke i ngulitur përfundimisht të dhënat për çdo rast të mëvonshëm. Kërkesa e katërt është që teksti të mos ndryshohet brenda periudhave të shkurtra sepse ndryshimet e shpejta gjuhësore do të sillnin vështirësi në jetën shtetërore. Pra, teksti është shumë homogjen nga ana stilistike dhe paraqitja është e njëtrajtshme. Ky tip dokumentesh i përket stilit konvencional dhe tradicional.<sup>8</sup> Ajo që është më e rëndësishme në versionin final të tekstit është natyrshmëria gjuhësore apo ruajtja e aspektit stilistik.<sup>9</sup>

*Ilustrime të funksionit stilistik të marra nga teksti i Konventës për Municionet Thërrmuese:*

Natyra autoritative e tekstit është shprehur përmes disa tipareve gjuhësore të cilat i kemi renditur më poshtë duke përdorur metodën statistikore:

- 1) Folja “shall” e cila nënkupton detyrim juridik është përmendur 90 herë në këtë konventë.
- 2) 25 fjali në këtë konventë fillojnë më frazën “*Each State Party shall...*” në shqip “*Çdo Shtet Palë*. Përdorimi i vetës së parë numri njëjës në vend të emrit në shumës “*The State Parties*” në shqip “*Shtetet Palë*” do të thotë se konventa i adresohet secilit shtet në veçanti, dhe jo në mënyrë kolektive. Emrat përgjithësues mund të nënkuptojnë mungesë përgjithësie individuale. Përcaktori “each”, (në shqip “secili”), thekson referencën direkt të secilit nga shtetet palë. Me fjalë të tjera, rezultat e parashtruara në konventë priten të arrihen nga secili shtet në mënyrë individuale.
- 3) Përdorimi i kohës së tashme të thjeshtë. Shembull: *Each state party undertakes...*, *Each state party believes...*, (në shqip “*Çdo shtet palë ndërmerr...*, *Çdo shtet anëtar beson...*”) Është pothuajse e pamundur të gesh një kohë tjetër folje në të gjithë tekstin. Koha e tashme nënkupton urgjencën e

---

<sup>8</sup> Ibid., p. 204.

<sup>9</sup> Viktor Ristani, *Kontribut në Studimet Përkthimore Gjatë Viteve '90*. Tirana, 2010, p. 212.

veprimit dhe kohën apo kohëzgjatjen e kushteve të parashtruara prej tij. Gjithashtu, nënkupton se shtetet palë janë ligjërisht të detyrueshëm ta zbatojnë konventën në çdo kohë që i referohen.

- 4) Përdorimi i foljes në formën e pashtjelluar në anglisht (infinitive në shqip paskajorja) e cila në versionin e përkthyer korrespondon me folje në formën e shtjelluar në mënyrën lidhore ka një rol detyrues:

Each State Party undertakes never under any circumstances to: (a) <u>Use cluster munitions</u> ; (b) <u>Develop, produce, otherwise acquire, stockpile, retain or transfer</u> to anyone, directly or indirectly, cluster munitions; (c) <u>Assist, encourage or induce</u> anyone to engage in any activity prohibited to a State Party under this Convention. <b>Pg. 3</b>	Çdo Shtet Palë, në asnjë rrethanë, nuk duhet të: (a) Përdorë municione thërrmuese; (b) <u>Zhvillojë, prodhojë, të marrë, grumbullojë, mbajë ose transferojë</u> tek askush, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, municione thërrmuese; (c) <u>Ndihmojë, inkurajojë ose tërheqë</u> dike tjetër për t'u angazhuar në aktivitete që janë të ndaluara për Shtetet Palë në këtë Konventë <b>Pg. 3</b>
--	---

Për sa i përket funksionit të dytë normativ që Prof. Lloshi sugjeron, të gjitha termat ligjore dhe ushtarake konsiderohen si të tilla pasi ato i përkasin sistemit të termave, pra njihen si të tilla dhe bashkërisht përdoren nga ekspertët e fushës. Pra, përkthyesi duhet t'i referohet këtij fondi termash me qëllim që të shmangë keqkuptimet. Shembujt e mëposhtëm e ilustrojnë këtë:

- 5) Termi "*Victim assistance*" mund të konsiderohet një term thjeshtë për t'u kuptuar në anglishten standarde. Megjithatë, në këtë kontekst kanë një kuptim tjetër. Fjala "victim" e ndjekur nga fjala "assistance" është shumë e rëndësishme në këtë kontekst pasi përbënë një ndër tre shtyllat e kësaj konvente. Fjala "victim" në anglisht dhe "viktimë" në shqip mbartin kuptime të ndryshme. Në anglisht kjo fjalë i

referohet të aksidentuarve dhe të mbijetuarve. Në shqip e kemi përshtatur “*asistencë ndaj të aksidentuarve*”.

- 6) “*Cluster Munitions*” është një term me ndjeshmëri të lartë. Për sa i përket përkthimit, përkthyesi nuk ka zgjidhje tjetër për duhet të konsultohet me ekspertët në fushën ushtarake sepse ky term i përket zhargonit ushtarak dhe përkthyesi nuk mund të prezantojë një term të ri. Në shqip është përshtatur “*municione thërrmuese*”.

Tipari i tretë i propozuar nga Prof. Xhevat Lloshi mund të analizohet nëpërmjet studimit të korpusit. Pothuajse të gjitha konventat ndërkombëtare kanë të njëjtat tipare strukturore, stilistike dhe sintaksore. Pra, ky stil konsiderohet si i parapërcaktuar dhe nuk mund të ndryshohet.

Toni i gjuhës ka karakteristikat e veta gjithashtu. Sipas Xhevat Lloshit, toni i gjuhës juridike është qëllimisht i përmbajtur, korrekt, madje i ftohtë ose me mirësjellje formale. Kjo arrihet duke shmangur mjetet me ngjyrimë subjektive, stilemat emocionale dhe shprehëse. Hartuesi i paraqitjes gjuhësore është i shtrënguar të plotësojë detyrën e vetë me një parashtrim metodik, zyrtar, objektiv e të ftohtë.<sup>10</sup> Në asnjë mënyrë përkthyesit nuk i lejohet të paraqesë interpretimin/mendimin e tij në tekst, dhe është absolutisht e ndaluar që ai/ajo të marrë mundimin ta bëjë një gjë të tillë në një tekst juridik. Sipas Deborah Cao, puna e përkthyesit të termave ligjore nuk është të japë këshilla ligjore dhe të zgjidhë probleme ligjore por të përkthejë dhe të mundësojë komunikimin me anë të gjuhës midis barrierave gjuhësore, juridike dhe kulturore.<sup>11</sup>

Të gjitha këto tipare janë shprehur qartë në këtë konventë. Asnjë përcaktor emotiv nuk mund të gjendet në tekst. Asnjë opinion personal i hartuesit nuk mund të gjendet gjithashtu. Roli i përcaktorëve në këtë tekst është informativ dhe gramatikisht ato shprehen me emra dhe shumë pak mbiemra neutralë. Shembull: *gender-sensitive assistance, munition victims, coordinated manner, national*

---

<sup>10</sup> Xhevat Lloshi, *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, Second Edition, Tirana, 2005, fq. 205.

<sup>11</sup> Deborah Cao. *Translating law*. Clevedon, 2007, fq.4.

*stockpiles, fundamental freedom, human rights, medical care, proposed extenuation, suspected hazardous areas, total area, socio-economic and environmental implications, relevant guidelines.*

### **Standardizimi i termave dhe koncepteve ligjore gjatë përkthimit**

Në mënyrë që të reduktojmë mosmarrëveshjet ndërkombëtare në fushën e dokumenteve juridike, duhet të ekzistojë një formë standard e koncepteve ligjore, e cila nuk bazohet në zgjedhjen mekanike të kuptimit por përfshin një zgjedhje në nivel tekstor dhe kontekstual. Pyetja që ngrihet këtu është: Çfarë duhet standardizuar?

Procesi i standardizimit nuk do të thotë të kërkosësh për ngjashmëritë. Kierzkoëska sugjeron një metodë për të arritur këtë objektiv në fushën e dokumenteve juridike. Ajo thotë se hapi i parë duhet të jetë mbledhja e informacionit bazë i cili është zhvilluar tashmë në këtë fushë në vendin e origjinës dhe në vendin e gjuhës së përkthimit. Pra, me anë të studimeve krahasuese, një grup pune i veçantë mund të sugjerojë zgjidhje.<sup>12</sup> Megjithatë, kjo metodë kërkon shumë kohë.

Një metodë tjetër me anë të cilave barasvlerat e termave ligjorë standardizohen janë të identifikojë rregullsitë dhe modelet në zgjedhjet e bëra nga përkthyesi dhe të cilat tregojnë se ata udhëhiqen nga norma gjuhësore gjatë procesit të përkthimit. Pra, duhet pranuar se norma gjuhësore luan një rol të rëndësishëm në standardizimin e termave ligjorë. Gjithashtu, uniformiteti i termave brenda një teksti është e rëndësishme. Do të krijohej ambiguitet dhe konfuzion nëse një term i vetëm të prezantohej në gjuhën e përkthimit me dy apo më shumë variante, edhe pse këto variante do të ishin sinonime dhe do të mbartnin pak a shumë të njëjtin kuptim.

---

<sup>12</sup> Kierzkowska, D. International Unification of Court Translators' Principles of Work- Needs and Possibilities, In Ne keman, *Translation: Our Future Proceedings of the XIth World Congress of FIT Euroterm Maastricht: Euroterm, 1987. p. 441.*

Megjithatë, me standardizim nuk nënkuptojmë vetëm nivelin leksikor. Sipas Prf. Xhevat Lloshit, zgjidhja stilistike për të mishëruar këto kërkesa i nënshtrohet një parimi drejtues organizimi: standardizimi i përfunduar dhe sa më i lartë. Stereotipia shfaqet në disa nivele: togje e fjali steritipike, ndërtimi sintaksor deri tek organizimi i paragrafëve; strukturimi i të gjithë tekstit deri te paraqitja shkrimore tërësore. Në rast se standardi nuk respektohet, ka shumë gjasa që teksti të quhet i pavlefshëm për qëllimin e dhënë.<sup>13</sup>

### *Analizë gjuhësore stilistike e tekstit në origjinal dhe veçoritë e saj*

Rëndësia e gjuhës së origjinalit dhe veçoritë e tij nuk duhen nënvlerësuar. Kjo konventë është hartuar nga Kombet e Bashkuara dhe konsiderohet një konventë ndërkombëtare. Përmbajtja e saj i përket një nën-stili të veçantë juridik i cili ka një natyrë shumë komplekse. Ndryshon rrënjësisht nga stili normal formal. Kjo mënyrë e të shkruarit mund të zotërohet vetëm me një formë të specializuar shkollimi. Është më shumë se një zhargon profesional pasi përmban një leksik të specializuar dhe ndërtime sintaksore të veçanta.<sup>14</sup>

Më poshtë do të japim shembuj të vjelë nga Konventa për Municionet Thërrmuese ku demonstrohen kompleksiteti dhe veçoritë e përmbajtjes së këtyre dokumenteve:

Një tipar i dukshëm në tekstin e konventës është periudha shumë e gjatë dhe komplekse e përbërë nga struktura paralele ose si fjali homogjene".<sup>15</sup> Periudha në preambulën e konventës e ilustron këtë tipar: janë 20 si fjali homogjene në periudhë, tipike për një konventë ndërkombëtare. Ato janë formale dhe shprehin një listë arsyeshe pse ky akt ligjor u vendos të hartohet. Preambula mbart tonin diplomatik i cili do të theksohet me tej edhe te nenet e konventës. Shembull: *deeply*

---

<sup>13</sup> Xhevat Lloshi, *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, Second Edition, Tirana, 2005, p. 206.

<sup>14</sup> Mok, O. *Accessibility of Specialized Lexicon as Criterion for Quality Assessment of Legal Translation*. Babel, 1995. p. 196.

<sup>15</sup> Ibid. 197.



concerned that civilians... ;determined also to ensure...; Resolved to do...; recognizing the need...;bearing in mind...; etj.

Një tipar tjetër janë fjalitë me ndajshtim, të cilat janë elemente apo njësi kuptimore të vendosura në një fjali për ta bërë atë më komplekse. Këto njësi mund të jenë togfjalësha emërore, dhe përemërorë të cilat e ndajnë dhe foljen nga kallëzuesi duke krijuar vështirësi në mënyrën e të kuptuarit të fjalisë. Në nenin e parë, këto elemente janë vendosur në mënyrë që të vendosin të gjithë informacionin në një periudhë. Shembull: *Each State Party shall, in accordance with national regulations, separate all cluster munitions under its jurisdiction and control from munitions retained for operational use and mark them for the purpose of destruction. A State Party may, in exceptional circumstances, request additional extensions of up to four years.*

Fjalitë veprare janë përdorur dukshëm në tekstin e kësaj konvente për të treguar natyrën performative të gjuhës ligjore. Në mënyrë indirekte nënkupton kush do bëjë çfarë. Përdorimi i fjalive joveprare është i pranishëm gjatë gjithë tekstit edhe kur fokusi bie mbi kundrinorin. Më poshtë një shembull në fjali joveprare ku theksi bie mbi kundrinorin: Shembull: *A request for an extension shall be submitted to a Meeting of States Parties or a Review Conference prior to the expiry of the time period referred to in paragraph 1 of this Article for that State Party. Each request shall be submitted a minimum of nine months prior to the Meeting of States Parties or Review Conference at which it is to be considered.* (pg.8)

Gjithashtu, vërejmë se ekziston përdorimi i tepërt i togfjalëshave përemërorë. Ky është një tipar i kudogjendur në dokumentet e anglishtes juridike dhe shfaqet gjithashtu në tekstin që po shqyrtojmë. Ky përdorim i shpeshtë i përemrave është për shkak të fjalive të gjata dhe komplekse pasi përemrat janë mjete shumë efikase për të lidhur fjalitë brenda një periudhe. Shembull: *The adoption of the Protocol on Explosive Remnants of War; The protection of civilians from the effects of cluster munitions remnants in post-conflict environments; The Declaration of the Oslo Conference on Cluster Munitions*

Përdorimi i shpeshtë i togfjalshave përemëror tregojnë gjithashtu nivelin e lartë të emëzimeve në anglishten ligjore me prezencën e nyjes së trajtës së shquar "the" në pothuajse të gjitha fjalitë. Shembul:

*The adoption of the Protocol; The conduct of military operations; The destruction of all cluster munitions; The Meeting of States Parties, the provisions of Article 1.*

Gjithashtu, vërejmë një mungesë të thellë në përdorimi e fjalive mohore. Është shumë e dukshme që aktet janë lëshuar me mjetin rregullues në formën pohore “shall” dhe jo me formën mohore “shall not”, edhe pse përdorimi i fjalive mohore dhe i fjalëve të dyfishta mohore është një praktikë e përdorur në këto lloje tekstesh. Arsyeja për këtë mungesë të përdorimit të formave mohore direkte është për shkak se ky dokument është një konventë ndërkombëtare dhe si e tillë theksohet se çfarë shtetet palë duhet të bëjnë dhe jo çfarë nuk duhet të bëjnë. Shembull: *Each State Party shall make every effort to collect reliable relevant data with respect to cluster munitions victims.*

Një tipar tjetër të cilin e kemi shqyrtuar gjatë analizës të tekstit është përdorimi i termave të specializuara (leksiku juridik). Termat në përgjithësi merren nga përdorimi i veçantë i lidhur me temën i emrave dhe ndonjëherë edhe i foljeve. Termi mund të jetë një fjalë e vetme ose një togfjalësh. Kaiser-Cook thotë se “karakteristikat e një termi që e dallojnë atë nga një jo-term janë precizionet dhe fakti se ai i përket sistemit të termave, të cilat janë manifestime gjuhësore të sistemit të koncepteve.<sup>16</sup> Temat në këtë tekst i përkasin fushës politiko-diplomatike, juridike dhe ushtarake. Shembull: *comply, commit, undertake, prevent, recognize, accept, approve, accede, ratify.*

Sistemi i termave këtu përfshinë një set emrash dhe togfjalëshash emërore të standardizuara dhe të pandryshueshme. Shembull: *National implementation, state parties, Security Council, military personnel, settlement of the dispute.*

Një karakteristikë tjetër e këtij materiali janë termat ushtarakë, moskuptimi i të cilave shkakton probleme teknike dhe mbart ndjeshmëri ushtarake, p.sh: *cluster munitions, failed cluster munitions, unexploded submunition, cluster monition remnants, self-destruction mechanism”, self-deactivating, explosive bomblets.* Këto terma mund të

---

<sup>16</sup> Kaiser-Cook, Murder in the Laboratory: Termhood and the Culture Gap. In Snell-Hornby, *Translation as Intercultural Communication*, John Benjamins Publishing, 1997, fq. 284.

gjenden në nenin shpjegues të konventës, të shoqëruar nga përkufizimet e tyre sepse është shumë e rëndësishme që të gjitha shtetet palë në konventë, sa herë që të organizojnë takime ndërkombëtare midis tyre apo të raportojnë te Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara t'i referohen të njëjtit objekt kur ata përmendin "municionet thërrmuese", apo ndonjë tip tjetër municionesh.

### ***Vështirësitë gjuhësore të paraqitura në gjuhën e burimit (SL)***

Vendimet e marra nga përkthyesi janë të rëndësishme jo vetëm në aspektin gjuhësor por edhe në nivel juridiko-politik. Vendimi i marrë nga përkthyesit varet sidomos nga interpretimi juridik i tekstit. Me qëllim që të identifikojmë vështirësitë e hasura në gjuhën e origjinalit, duhet të bëjmë një shqyrtim të saktë të interpretimit ligjor. Analiza juridike nxjerr në pah vështirësitë e përkthimit dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre duke përdorur barasvlerën e saktë. Kemi zgjedhur dy ekstrakte të komplikuar për të demonstruar kompleksitetin e tekstit dhe mundësitë e keqinterpretimit gjatë procesit të përkthimit: dy sifjali të varura homogjene të marra nga preambula e konventës:

Basing themselves on the principles and rules of <u>international humanitarian law</u> , in particular the principle that the right of parties to an armed conflict to choose methods or means of warfare is <u>not unlimited</u> , and the rules that <u>the parties to a conflict shall</u> at all times distinguish between the civilian population and <u>combatants</u> and between civilian objects and military objectives and accordingly direct their operations against <u>military</u>	Duke u bazuar në parimet dhe rregullat e <u>ligjit humanitar ndërkombëtar</u> , në veçanti parimin që e drejta e palëve në një konflikt të armatosur për zgjedhjen e metodave ose mjeteve të luftës është e kufizuar, dhe për rregullat që <u>palët në një konflikt duhet të bëjnë dallimin ndërmjet popullsisë civile dhe luftëtarëve</u> si dhe ndërmjet objekteve civile dhe <u>objektivave ushtarake</u> dhe në këtë këndvështrim t'i drejtojnë operacionet e tyre vetëm kundër <u>objektivave ushtarake</u> , dhe që në
---	--

<p><u>objectives</u> only, that in the conduct of military operations constant care <u>shall</u> be taken <u>to spare</u> the civilian population, civilians and civilian objects and that the civilian population and individual civilians enjoy general protection against dangers arising from military operations, HAVE AGREED as follows: <b>pg 2</b></p>	<p>sjelljen e operacioneve ushtarake <u>duhet</u> të kushtohet kujdes i vazhdueshëm <u>për të kursyer jetët</u> e popullsisë civile, civilët dhe objektet civile dhe që popullsia civile dhe individët civilë të gëzojnë mbrojtjen e përgjithshme ndaj rreziqeve që vijnë nga operacionet ushtarake, KANË RËNË DAKORT si më poshtë : <b>pg 2</b></p>
--	--

Përkthyesi përballet me një sifjali të varur e cila është shumë formuluese, komplekse dhe gati sa një paragraf e gjatë. Ajo që është më konfuzuese janë termat të cilat në një kontekst tjetër nuk konsiderohen si të tilla. Dilema e parë me të cilën përballet përkthyesi është nëse duhet ta ndajë fjalinë në dy apo me shumë fjali të tjera në mënyrë që ta bëjë atë më të thjeshtë dhe të kuptueshme apo të ruajë formën e tekstit në origjinal.

Megjithatë, në këtë rast nuk kemi mundësi zgjedhje sepse kemi të bëjmë me një sifjali të varur e cila nuk mund të qëndrojë e vetme, aq më pak të ndahet në dy apo më shumë pjesë. Schaffner ka një shpjegim tjetër për sa i përket nivelit strukturor. Ajo sugjeron se një fjali në gjuhën e origjinalit duhet patjetër të korrespondojë me një fjali në gjuhën e përkthimit, dhe në rastin e traktateve, negociatorët “duhet të jenë në gjendje t’i referohen “nenit 1, paragrafi 2, fjalia 3 pa i shkaktuar keqkuptime kolegjëve të tyre.<sup>17</sup>

Kjo sifjali e varur përbëhet nga 6 nën-fjali, katër nga të cilat janë fjali me përemra lidhorë. Ngrihet pyetja: cilat prej tyre janë fjali homogjene me të parën: “*Basing themselves on the principles and rules of international humanitarian law*” dhe cilat janë të ndajshuara dhe të nënrenditura më të? Përcaktimi i marrëdhënieve sintaksore midis tyre

---

<sup>17</sup> Susan Šarčević, Translation of Culture-Bound Terms in Laws. In Sager, J.C. *Multilingua: Journal of Inter-language Communication*. Amsterdam: Mouton Publishers, 1985, fq.121.

do të na ndihmonte të kuptonim më saktë fjalinë. Sistemi i pikësimit ndihmon gjithashtu.

Folja modale "shall" ka një kuptim tjetër në kontekstin juridik dhe diplomatik. Versioni i saktë në shqip është "duhet". Megjithatë, përkthyesit në shqip kanë vendosur të përdorin vetëm kohën e tashme dhe të mos e përkthejnë fjalën "shall" sepse ligjet kur shkruhen në shqip gjithmonë përdoret koha e tashme.

Një tjetër problem me të cilin përkthyesi përballët, është shprehja përemërore: "*on the principles and rules of international humanitarian law*". Përpara se ta përkthejmë këtë frazë, përkthyesi duhet të qartësojë rolin e mbiemrit "humanitarian". A i referohet ky mbiemër ligjit i cili adreson çështje humanitare siç është zvogëlimi i varfërisë në botë, apo i referohet çështjeve civile për kundër atyre ushtarake? Në të dyja rastet, për arsye se kjo fjalë është një term juridik, siç është ligji penal, apo ligji administrativ, përkthyesi duhet të ketë parasysh faktin se duhet të ekzistojë një ekuivalencë e përdorur me parë për këtë term. Versioni përfundimtar është "*ligji ndërkombëtar humanitar*".

Një tipar tjetër i "sikletshëm" janë fjalitë me forma mohore të dyfishta: "*is not unlimited*". Ngrihet pyetja: A duhet t'i qëndrojmë besnik gjuhës së origjinalit dhe ta përkthejmë "nuk është e palimituar" apo të ta thjeshtojmë atë duke përdorur sinonimin e saj "është e kufizuar".

"*The parties to a conflict*" është një frazë tjetër problematike. Para së gjithash, ajo është shumë e përgjithshme. A i referohet fjala "party - palë" vetëm forcave të armatosura apo përfshihen gjithashtu banorët e zonës të cilët mund të preken në mënyrë indirekte, apo përfshin shtetet të cilët mund të jenë zyrtarisht dhe politikisht anëtarë (palë). Së dyti, çfarë mund të konsiderohet "konflikt" në një vend demokratik ku mbizotëron shteti i së drejtës dhe paqja nuk mund të konsiderohet si i tillë në një vend tjetër më pak demokratik. Së treti, a përfshihen armët? Fjala është shumë e thjeshtë për t'u përkthyer por mund të lërë hapësirë për dykuptimshmëri dhe keqinterpretime.

Fjala "*Combatants*" sipas fjalorit anglisht-shqip të Pavli Çeskut është përkthyer "*luftëtar*". Kjo fjalë në shqip ka një konotacion historiko-kulturor sepse është përdorur shumë nëpër filma gjatë regjimit komunist si dhe në tekstet e shkollave në atë periudhë. Kjo do të thotë

se shqiptarët kthehen në kohë kur vihen në kontakt me këtë fjalë. Megjithatë, është më e sigurt të përdorim këtë fjalë sesa të rrezikojmë dhe ta limitojmë kuptimin me fjalën “ushtarak” pasi kjo fjalë i referohet vetëm forcave të armatosura.

“*Military objectives*” ngrënë pyetjen nëse “*objectives*”<sup>18</sup> i referohet në mënyrë abstrakte gjërave që dikush duhet të arrijë në jetë apo është një target për ushtrinë në zonën e betejës? Konteksti na ndihmon të arrijmë në konkluzionin se shembulli i dytë është kuptimi i saktë. Konteksti na ndihmon në gjetjen e kuptimit të saktë, ku në këtë rast është shembulli i dytë.

“*To spare the civilian population*”, sipas fjalorit Oxford Advanced Dictionary do të thotë: “to allow somebody, something to escape harm, damage or death, especially when others do not escape it” – të lejojsh që dikush apo diçka t’i shpëtojë dëmit apo vdekjes, sidomos kur të tjerët nuk mund t’i shpëtojnë”. Përkthimi fjalë për fjalë në shqip nuk do të tingëllonte shumë natyrale: “për të kursyer popullsinë civile”. Në këtë rast duhet të shtojmë fjalën “*jetën*” për ta bërë kuptimin e saktë, “për të kursyer jetën e popullsisë civile”.

<p>Article 3 <u>Storage and stockpile destruction</u> 1. Each State Party shall, <u>in accordance with national regulations</u>, separate all cluster munitions under its jurisdiction and control from munitions retained for operational use and <u>mark</u> them for the purpose of destruction. pg 5</p>	<p>Neni 3 <u>Magazinimi dhe shkatërimi i stokeve</u> 1. Çdo Shtet Palë, <u>në përputhje me rregulloret kombëtare</u>, duhet të ndajë të gjitha municionet thërrmuese nën juridiksionin e vet dhe duhet t’i kontrollojë nga municionet e mbajtura për përdorim operacional dhe duhet t’i regjistrojë për t’i shkatërruar. pg 5</p>
--	---

<sup>18</sup> Sipas fjalorit *Longman Language Activator*

Titulli i nenit është shumë teknik sepse përfshinë terma ushtarakë. "Storage and stockpile destruction". të tria fjalët janë tashmë terma të përdorura në komunitetin ushtarak. Ato janë pjesë e zhargonit ushtarak dhe nëse ndryshohen gjatë përkthimit do të shkaktonin keqkuptime të lexuesi. Përkthyesi në këtë rast duhet t'i pyesë specialistët e fushës ose t'i konsultojë përkthimet e mëparshme të këtyre termave. Në këtë rast ne nuk mund të luajmë me sinonimet e tyre. "Magazinimi" është i vetmi opsion duke lënë jashtë sinonime si: "depozitimi" ose "ruajtja". Titulli i këtij neni, siç e shohim, përbëhet nga dy emra kundërshtues "storage" dhe "destruction" dhe në versionin e përkthyer duhet të ruhet e njëjta forcë kundërshtuese.

The verb "to mark" në kontekstin ushtarak shkon përtej kuptimit "shënjoj" në shqip. "Marking" në kontekstin ushtarak nënkupton më shumë sesa një procedurë shënjimi në terren. Ajo përfshin edhe regjistrimin në dosjet ushtarake. Pra është më e sigurt ta përkthejmë "shënjimi dhe regjistrimi".

Këto shembuj ilustrjnë faktin se përkthyesi duhet t'i konsiderojë tri aspekte të tekstit gjatë procesit të përkthimit: kuptimin semantik të tekstit, kuptimin pragmatik si dhe të kuptojë të gjithë background-in e krijimit të një teksti juridik-diplomatik të cilat janë konteksti dhe kompetencat jashtëgjuhësore. Me kompetencat jashtëgjuhësore nënkuptojmë situatën në të cilën ky tekst u krijua, gjuhën teknike dhe metodat e përdorura për këtë qëllim, lexuesit të cilit ky material po i adresohet, dhe ajo që është më e rëndësishmja, forcën dhe të vërtetën e tekstit. Gjithashtu, duhet të përfshijë edhe kulturën e të dyja teksteve: të originalit dhe gjuhës së përkthimit.

### ***Përfundime:***

Është tashmë e qartë se procesi i përkthimeve të dokumenteve juridike përfshijnë disa disiplina: kompetencat gjuhësore dhe kompetencat juridike dhe komunikimi ndërkulturor. Kjo na çon në përfundimin se ky proces mund të konsiderohet si një "operacion

multidisiplinar”.<sup>19</sup> Është gjithashtu e qartë se përkthyesi i një teksti juridik duhet të ketë aftësinë të kuptojë qëllimin dhe mesazhin në gjuhën e origjinalit. Ndërsa Lane shprehet “përkthyesi në asnjë mënyrë nuk duhet të përfshijë interpretimin e tij personal të tekstit, dhe është absolutisht e ndaluar që ai madje të denjojë të interpretojë sipas mënyrës së vet përmbajtjen ligjore”.<sup>20</sup> Është statusi dhe pozicioni i autorit, apo institucioni të cilin ai/ajo e prezanton që i jep autoritet tekstit. Tekstet ligjore mbartin forcën e ligjit; ato janë instrumenti me të cilin ligji aplikohet. P. sh. mjeti gjuhësor “*shall - duhet*” ka një rol urdhërues në kontekstin ligjor.

Gjithashtu, studiuam stilin dhe tonin e kësaj konvente dhe se si funksioni stilistik i tekstit kontribuon në tonin autoritar të konventës. Është e rëndësishme të theksojmë faktin se nuk ka vend për shprehësi, reagim dhe ndjenja personale. Fjalët e zgjedhura nga përkthyesi nuk duhet të kenë asnjë ngarkesë emocionale apo interpretim të njëanshëm. Një aspekt tjetër i shkrimit dhe përkthimit të teksteve juridike është standardizimi i terminologjisë dhe uniformiteti si në nivelin makro-tekst dhe në atë mikro-tekst.

Në këtë kumtesë ne gjithashtu analizuam vështirësitë me të cilat përkthyesi përballet gjatë përkthimit të traktateve ndërkombëtare. Kemi analizuar dy fjali nga teksti, duke demonstruar natyrën formuluese të fjalive dhe kompleksitetin e stilit ligjor. Gjithashtu, versioni i përkthyer duhet të ketë të njëjtën strukturë vizuale me atë të origjinalit, stili dhe regjistri duhet të ruhen, duke pasur parasysh përshtatjen kulturore dhe pragmatike.

Tekstet me natyrë politiko-diplomatike, dhe veçanërisht traktatet ndërkombëtare, janë të konvencionalizuara, pra kanë karakter tradicional. Këto konvencione gjuhësore shfaqen në nivel leksikor, sintaksor dhe strukturor.

Si përfundim, përkthyesi duhet të konsiderojë tre aspekte të tekstit gjatë procesit të përkthimit: kuptimin semantik të tekstit, kuptimin

---

<sup>19</sup> Stuart Campbell, *Translation into the Second Language*. New York, 1998, fq. 447.

<sup>20</sup>Alexander Lane, *Legal and Administrative Terminology and Translation Problems, Langage du Droit et Traduction*. Conseil de la langue Franciase, 1982, Fq. 223.



pragmatik si dhe të kuptojë të gjithë background-in e krijimit të një teksti juridik-diplomatik të cilat janë konteksti dhe kompetencat jashtëgjuhësore. Me kompetencat jashtëgjuhësore nënkuptojmë situatën në të cilën ky tekst u krijua, gjuhën teknike dhe metodat e përdorura për këtë qëllim, lexuesit të cilit ky material po i adresohet, dhe ajo që është më e rëndësishmja, forcën dhe të vërtetën e tekstit. Gjithashtu, duhet të përfshijë edhe kulturën e të dyja teksteve: të originalit dhe gjuhës së përkthimit.

## ***Bibliografia***

Campbell. S. *Translation into the Second Language*. New York: Addison Wesley Longman, 1998.

Cao, D. *Translating law*. Multilingual Matters: Clevedon, 2007.

Dante, B. *Language in the Legal Process*. In *Law & Society Review*. 1980.

Lloshi, Xh. *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, Second Edition, Tirana, 2005.

Lane, A. *Legal and Administrative Terminology and Translation Problems, Langage du Droit et Traduction*. Conseil de la langue Franciase, 1982

Kaiser-Cook, M. *Murder in the Laboratory: Termhood and the Culture Gap*. In Snell-Hornby, *Translation as Intercultural Communication*, John Benjamins Publishing, 1997.

Kierzkowska, D. *International Unification of Court Translators' Principles of Work- Needs and Possibilities*, In Ne keman, P. *Translation: Our Future Proceedings of the XIth World Congress of FIT Euroterm Maastricht: Euroterm*, 1987.

Ristani, V. *Kontribut në Studimet Përkthimore Gjatë Viteve '90*. Tirana, 2010.

Trosborg, *Text Typology and Translation*: John Benjamins Publishing, 1997